



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

Rruga Ukshin Kovaqica, Mitrovicë, Republika e Kosovës Tel: +381-28530446

Rektori i UMIB-it :

Nr. Prot. 090

Prof. dr. Alush Musaj

Datë: 21/01/2020

Në mbështetje të nenit 25 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, pas kërkesave të stafit akademik dhe me qëllim të sqarimit të pikës 1 (një) të vendimit të Këshillit Drejtues Nr. Prot. 443/005, të datës 31. 3.2017, rektori i UMIB merr:

VENDIM

- I. Orari i plotë i punës për stafin akademik zgjatë 40 orë në javë.
- II. Orari i plotë i punës së stafit akademik nuk është i lidhur me procesin administrativ ardhje/dalje në Universitet nga ora 08.00 deri në ora 16.00.
- III. Respektimi i orarit të punës lidhet me përmbushjen e detyrave akademike siç janë: përgatitja e ligjëratave dhe ushtrimeve, mbajtja e mësimit, konsultimet, kontrollimi i detyrave dhe aktivitetit të studentëve, hulumtimi akademik dhe kryerja e detyrave tjera akademike shkencore sipas statutit dhe akteve tjera të universitetit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Vendimi t'i dërgohet

- Arkivit të Universitetit
- Menaxhmentit
- Fakulteteve
- Zyrës për çështje akademike
- Zyrës së personelit

Rektori i UMIB-it

Prof. dr. Alush Musaj

